



Republika e Kosovës
Република Косово - Republic of Kosovo
Qeveria - Влада – Government

Ministria për Komunitete dhe Kthim / Министарство за заједнице и повратак /
Ministry of Communities and Return

**THIRRJE PUBLIKE PËR FINANCIMIN E AKTIVITETEVE TË ORGANIZATAVE TË
SHOQËRISË CIVILE TË DREJTUARA PËR RITJEN E PUNËSIMIT TË ANËTARËVE TË
KOMUNITETEVE JO-SHUMICË**

**Fushë Kosovë,
03.06.2026**

Kjo thirrje publike për propozime projektesh nga organizatat e shoqërisë civile synon forcimin e pozicionit socio-ekonomik të anëtarëve të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, përmes mbështetjes së iniciativave që kontribuojnë në integrimin e tyre aktiv në tregun e punës dhe përmirësimin e aftësive dhe punësimit të tyre.

1. QËLLIMET E PROJEKTIT

Organizatat e shoqërisë civile në përputhje me këtë thirrje publike mund ti dorëzojnë aplikacionet me projekte, si më poshtë:

Kontribut në punësim, angazhim në praktikë dhe organizim trajnimesh me theks të veçantë tek gratë, të rinjtë, personat me aftësi të veçanta si dhe grupet e tjera të marginalizuara brenda komuniteteve jo-shumicë që jetojnë në Kosovë.

Qëllimi i këtij njoftimi publik është të mbështesë Ministrinë e Kthimit dhe Komuniteteve të Kosovës në zbatimin e misionit të saj. Misioni është të krijojë kushte për kthim të qëndrueshëm, mbrojtje, integrim dhe zhvillim të komuniteteve duke ndërtuar besim të ndërsjellë dhe duke ofruar mundësi të barabarta për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. Kjo arrihet nëpërmes

pranisë së vazhdueshme institucionale dhe shërbimeve efektive, duke marrë parasysh standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira.

Programi për financimin e aktiviteteve për ngritjen e nivelit të punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë.

1.1 Në përputhje me këtë thirrje publike, OJQ-të mund të aplikojnë me projektet/programet e tyre për fushat e mëposhtme prioritare:

1. Angazhimi i praktikantëve për praktikë në institucione dhe organizata të ndryshme;
2. Organizimi i trajnimit për aftësitë e buta (soft skills);
3. Rrjetëzimi profesional;
4. Trajnim për zanate të ndryshme, duke përfshirë por pa u kufizuar në trajnime për parukierë, rrobaqepës, marangozë, automekanikë etj., si dhe punësimin e praktikantit në këto punë.
5. Zbatimi i projektit duhet të mbulojë të gjitha rajonet në Kosovë.

1.2 Organizatat joqeveritare mund të aplikojnë me një projekt që kontribuon në angazhimin e praktikës dhe organizimin e trajnimeve për komunitetet në Kosovë, përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- Aktivitete që lidhen me angazhimin e praktikantëve duke investuar në trajnime dhe duke përvetësuar njohuritë e nevojshme për përfshirje në tregun e punës, me ç'rast përparësi kanë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të veçanta, si dhe grupet e tjera të marginalizuara brenda komuniteteve jo-shumicë;
- Aktivitete që lidhen me organizimin e trajnimeve të cilët do të promovojnë, zhvillojnë dhe ndërtojnë kapacitetet e komuniteteve për t'u bërë konkurruese në tregun e punës, si dhe do t'i pajisin ato me njohuritë e nevojshme për të qenë në gjendje të punojnë dhe mundësi të reja punësimi;
- Aktivitete që lidhen me krijimin e një rrjeti profesional ku do të ofrohet organizimi i aktiviteteve të përbashkëta për anëtarët e grupit të rrjetit dhe do të shkëmbehen informacione mbi mundësitë e punësimit ose trajnimit dhe do ta ndihmojnë njëri-tjetrin në zgjidhjen e problemeve që lidhen me punën.
- Vëmendje e shtuar ndaj çështjeve që lidhen me gratë nga komunitetet (për shembull, nivele më të larta të përfshirjes së grave në punësim, praktikë dhe trajnime).
- Aktivitete që synojnë përmirësimin e politikave qeveritare në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe interesave të komuniteteve në aspektin e punësimit;
- Aktivitete për zhvillimin e mundësive ekonomike për komunitetet dhe/ose anëtarët e komuniteteve jo-shumicë, ose trajnimin e tyre në gjenerimin e të ardhurave;

2. PROJEKTIMI FINANCIAR I THIRRJES DHE KUSHTET

- 2.1 Shuma maksimale e këtij projekti është 500.000 euro, ku shuma minimale edhe ajo maksimale që aplikuesi mund të aplikojë është deri në shumën maksimale të kësaj thirrjeje. Në të njëjtën kohë, shuma e kësaj thirrjeje mund të rritet ose të ndryshohet sipas disponueshmërisë së fondeve dhe numrit të aplikimeve.
- 2.2. Projektet mund të financohen në shumën prej 100% të totalit të shpenzimeve të pranueshme të projektit (7% është shuma maksimale e lejuar për shpenzimet administrative të aplikuesve);
- 2.3. Shuma minimale që një praktikanti mund të marrë si kompensim në baza mujore gjatë trajnimit është 500 euro (minimumi ligjor);
- 2.4 Kjo thirrje parashikon angazhimin e një minimumi prej 300 praktikantësh për kryerjen e praktikës në institucione dhe organizata të ndryshme;
- 2.5 Periudha e zbatimit të projektit është tre muaj;
- 2.6 Përparësi për këtë thirrje u jepet OJQ-ve që jo vetëm punojnë për komunitetin, por kanë edhe zyra në të gjitha rajonet e Kosovës.
- 2.7 Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është pesëmbëdhjetë (15) ditë pune dhe përfundon më 23.06.2026 në orën 16:00.
- 2.8 OJQ-të mund të aplikojnë me një maksimum prej një (1) projekti në kuadër të kësaj thirrjeje. E njëjta OJQ mund të jetë partnere në disa projekte në fushat prioritare të thirrjes.
- 2.9 Gjatë procesit që lidhet me praktikantët, Ministria, brenda kapaciteteve të saj institucionale dhe administrative, do të pranojë gjithashtu aplikimet e praktikantëve nga kandidatët e interesuar gjatë thirrjes publike.

Kalendari indikativ i përfundimit të thirrjes

03/06/2026 - Hapja e thirrjes

10.06.2026 - Afati i fundit për dorëzimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen 17.06.2026 -

Publikimi i përgjigjeve në faqen e internetit të MKK-së 23/06/2026 - Afati për

dorëzimin e propozimeve të projektit në MKK 26/06/2026 - Publikimi i rezultateve

paraprake, njoftimi i aplikuesve 30/06/2026 - Afati për dorëzimin e ankesave

03/07/2026- Vendimi i Komisionit të Ankesave

06.07.2026 - Nënshkrimi i kontratës

Lista complete e dokumenteve të nevojshme

Aplikimi do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjithë formularët e aplikimit dhe bashkëngjitjet e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si më poshtë:

1. Formulari i propozimit të ofertës
2. Formulari i propozim buxhetit
3. Formulari i Deklaratës së Partneritetit (nëse është e aplikueshme)
4. Kopja e certifikatës së regjistrimit të OJQ-ve;
5. Kopja e certifikatës së numrit fiskal;
6. Formulari i deklaratës për mungesë financimi të dyfishtë;
7. Formulari i aplikimit për projekte ose programe të OJQ-ve që financohen nga burimet e financimit publik;
8. Formulari i deklaratës për aktivitetet e përshkruara të programit/projektit;
9. Deklarata vjetore për vitin 2023,2024 dhe 2025, (nga ATK);
10. Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës për gjendjen e borxhit publik, e vlefshme në datën e dorëzimit të kërkesës, e cila vërteton se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të papaguara apo obligime të tjera tatimore, apo se është në marrëveshje për shlyejë të borxhit me ATK-në;
11. Para nënshkrimit të kontratës OJQ-ja duhet të dorëzojë dëshmi, se OJQ-ja dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetim për vepra penale;
12. Vërtetim nga banka e llogarisë aktive të organizatës joqeveritare para nënshkrimit të kontratës.

Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e kërkuar, të cilët së bashku me Udhëzimet për aplikuesit, janë të disponueshëm në faqen e internetit të MKK-së.

Dorëzimi i aplikacionit

Aplikimet dorëzohen në një zarf të mbyllur, ku në zarf vendoset një kopje e printuar e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm origjinal, si dhe një kopje elektronike në CD.

Dokumentet e kompletuara mund të dorëzohen fizikisht në adresën e mëposhtme ose të dërgohen me postë në këtë adres:

Ministria për Komunitete dhe Kthim
rru. Nëna Terezë, PN. 12000 Fushë Kosovë/Kosovë
Zyra e arkivit

Për mbështetje financiare do të shqyrtohen vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të përcaktuar në këtë thirrje publike dhe që i kanë plotësuar kushtet e thirrjes publike.

Kontakti

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen ekskluzivisht në mënyrë elektronike në adresën e mëposhtme: request.mkk.mzp.mcr@rks-gov.net jo më vonë se me 10.06.2026.

Përgjigjet do të kthehen në formë elektronike dhe do të publikohen në faqen zyrtare të MKK-së me 17.06.2026.

Udhëzimet për aplikuesit

Së bashku me këtë thirrje do të publikohen edhe **Udhëzimet për aplikuesit**, në lidhje me informacione më të detajuara rreth thirrjes publike.